KËRKESË

Kërkuese: Iris Ferhati, e bija e Mahmutit dhe Barijes, e datëlindjes 1965, lindur në Sotirë të Gramshit dhe banuese në fshatin Darëzezë të komunës Dermenas.

Objekti: Shpalljen të zhdukur të bashkëshortit tim Halit Shaban Ferhati.

Bashkëshorti im Halit Ferhati më 23 prill 1991 është larguar nga shtëpia për në Greqi për të punuar si emigrant ekonomik. Nga çasti i nisjes e deri më sot nuk kam asnjë informacion për vendndodhjen e tij, as postar, as telefonik, as gojor nga persona të tjerë. Edhe të afërmit e tij, gjithashtu, nuk kanë asnjë të dhënë. E kemi kërkuar nëpërmjet Kryqit të Kuq Shqiptar, me anë të radios e televizionit madje, unë kam shkuar vetë edhe në Greqi, po nuk kemi arritur të zbulojmë diçka.

Në këto kushte, kur unë dhe vajza jonë Ditjona Ferhati kemi interesa nga fakti i deklarimit të tij si i zhdukur, detyrohem ta kërkoj këtë nëpërmjet rrugës gjyqësore.

KËRKUESE
Iris Ferhati